

# COVID-19

## Informacion për komunitetin rom



Roma and Travellers

Ky informacion bazohet në një komunikim të mëparshëm nga Konferenca e Përhershme e Romëve në Bullgari dhe nuk përbën rekomandim zyrtar prej Këshillit të Evropës.

Ekipi për Romët dhe Udhëtarët pranë Këshillit të Evropës bashkon forcat me programet dhe projektet e përbashkëta të KiE/BE (ROMACT, INSCHOOL, ROMACTED dhe JUSTROM) për rritjen e ndërgjegjësimit mbi përhapjen e COVID-19 në komunitetin rom.

Shpërthimi i koronavirusit të ri (COVID-19) ka shkaktuar sfida të konsiderueshme në komunitetin rom në të gjithë Evropën. Romët janë veçanërisht të prekshëm nga krizat epidemike për shkak të aksesit të pamjaftueshëm në ujë të pastër dhe kanalizime të ujërave të zeza; infrastrukturës jo të mirë dhe aksesit të kufizuar në sistemet e kujdesit shëndetësor; keqshqyerjes; ndërgjegjësimit të ulët për masat parandaluese; dendësisë së lartë të popullsisë në vendbanime; udhëtimeve të shpeshta brenda vendit dhe atyre ndërkombëtare, si dhe mbulimit të ulët me vaksinim në disa vendbanime.

## Masat parandaluese në komunitet



### Fushata informimi online dhe offline për COVID-19

#### Masat parandaluese që duhet të merren

- Ndani informacion të përditësuar verifikuar nga burime të besueshme
- Lani duart
- Kur kolliteni ose teshtini, mbulojeni gojën me bërryl
- Qëndroni në shtëpi për të paktën 14 ditë në rast të ndonjë prej simptomave të renditura më poshtë

#### Grupet e rrezikuara


- Personat mbi moshën 60 vjeç
- Personat me sëmundje kronike si hipertension, diabet, sëmundje kardiovaskulare, sëmundje kronike respiratore dhe kancer

#### Simptomat

- Simptomat më të zakonshme: ethet dhe kolla e thatë
- Simptomat relativisht të zakonshme: lodhja dhe prodhimi i pështymës
- Simptoma jo të zakonshme: vështirësi në frymëmarrje, dhimbje fyti dhe bllokim hundësh

#### Si duhet të veproni nëse mendoni se jeni infektuar

- Ju lutemi, mësoni protokollet tuaja vendore të reagimit/menaxhimit dhe identifikoni se cilat objekte shëndetësore janë caktuar për menaxhimin e rasteve, si është organizuar transporti dhe cilët numra telefoni duhet të përdorin njerëzit nëse dyshojnë se dikush është infektuar
- Ju lutemi, mësoni se çfarë procedurash kanë vendosur autoritetet shëndetësore të vendit tuaj. Çfarë hapash konkretë duhet të ndërmerren njerëzit? Çfarë këshillash duhet t'u jepen familjeve dhe miqve të atyre që kanë qenë në kontakt me raste të konfirmuara




# COVID-19

## Informacion për komunitetin rom



Roma and Travellers



Në zonat ku janë aktive programet/projektet e përbashkëta të KiE/BE, mund të kontaktohet me pikat e kontaktit të bashkive, lehtësuesit, këshilluesit në fushën e arsimit ose organizatave mbështetëse të programeve/projekteve ROMACT, INSCHOOL, ROMACTED ose JUSTROM




Ndaloni të gjitha daljet jo të domosdoshme jashtë lagjeve tuaja



Ndani nevojat kolektive të vendbanimeve rome me ROMACT, INSCHOOL, ROMACTED ose JUSTROM dhe me ndërmjetësit dhe organizatat partnere



Merrni masa mbrojtëse dhe ndihmoni familjet më të prekshme që nuk kanë ujë të pijshëm, ata me sëmundje kronike, si dhe familjet me anëtarë të moshuar



Mos humbni besimin dhe shmangni panikun dhe konfliktet e brendshme.

- Pjesa më e madhe e njerëzve të infektuar kanë simptoma të lehta ose të moderuara dhe rikuperohen, por disa do të shfaqin simptoma të rënda
- Kjo sëmundje tek fëmijët duket relativisht e rrallë dhe e lehtë

## Nëse në një lagje rome haset një rast infektimi nga virusi

### Çfarë duhet bërë?

Fokusohuni tek ndalimi i përhapjes përmes izolimit

- Informoni publikun - online dhe offline - për çdo parregullsi në ofrimin e mbështetjes për komunitetin rom
- Informoni organizatat ndërkombëtare të shëndetit mbi nevojat e komunitetit dhe kërkesat për ndihmë mjekësore në rastet kur është e mundur

